

FOOD TRADE

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital neto	3
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5 – 24

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	5	269,083,028	282,309,187
Aktivitet afatgjata jomateriale	6	46,993,387	66,204,782
Parapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjata	7	85,164,167	106,356,219
Totali i aktiveve afatgjata		401,240,582	454,870,188
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	8	292,346,057	279,504,105
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	61,654,007	43,015,794
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	107,774,799	95,168,452
Llogari të arkëtueshme të tjera	11	12,814,233	15,205,981
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	17,665,108	13,945,049
Mjetet monetare në arkë e në bankë	13	140,415,689	94,692,694
Totali i aktiveve afatshkurtra		632,669,893	541,532,075
Totali i aktiveve		1,033,910,475	996,402,263
KAPITALI			
Kapitali themeltar		148,963,498	148,963,498
Rezerva ligjore		1,101,320	721,256
Fitime të mbartura		10,640,563	3,419,345
Fitimi i ushtrimit		(24,474,114)	7,601,282
Totali i kapitalit	14	136,231,267	160,705,381
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	36,905,149	96,669,611
Hua afatgjata nga ortaku	16	60,915,785	61,839,229
Totali i detyrimeve afatgjata		97,820,934	158,508,840
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	17	134,837,874	56,138,563
Llogari të pagueshme tregtare	18	90,506,213	98,320,164
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	19	540,715,087	486,528,262
Parapagimet e arkëtuara	20	257,928	281,624
Detyrime tatimore	21	25,901,478	28,814,139
Llogari të pagueshme të tjera	22	7,639,694	7,105,290
Totali i detyrimeve afatshkurtra		799,858,274	677,188,042
Totali i detyrimeve		897,679,208	835,696,882
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,033,910,475	996,402,263

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	2,357,043,388	2,503,516,506
Të ardhura të tjera	24	49,058,060	44,983,611
Total të ardhura		2,406,101,448	2,548,500,117
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	25	(1,867,275,955)	(2,030,064,846)
Shpenzime personeli	26	(114,545,113)	(100,909,551)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	27	(87,931,105)	(68,407,827)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	28	(358,856,349)	(334,160,487)
Total shpenzime		(2,428,608,522)	(2,533,542,711)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	29	(4,512,609)	(6,255,705)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	30	2,545,569	1,194,735
Fitimi/ humbja para tatimit		(24,474,114)	9,896,436
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	31	-	(2,295,154)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(2,295,154)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/ humbja e vitit		(24,474,114)	7,601,282
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(24,474,114)	7,601,282

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FOOD TRADE sh.p.k


Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim/ Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2015	148,963,498	721,256	-	3,419,345	153,104,099
Të ardhura totale gjithëpërfshirë për vitin:					
Transferim në rezervë ligjore			3,419,345		
Transferim në fitime të mbartura				(3,419,345)	
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	148,963,498	721,256	3,419,345	7,601,282	160,705,381
Totali i të ardhura gjithëpërfshirë për vitin:					
Transferim në fitime të mbartura			7,221,218	(24,474,114)	
Transferim në rezervë ligjore		380,064		(7,221,218)	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirë për vitin:				(380,064)	
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	148,963,498	1,101,320	10,640,563	(24,474,114)	136,231,267

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më ____ mars 2017 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Znj. Artenida Dule
Përgatitës i pasqyrave financiare



FOOD TRADE sh.p.k

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

**Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(24,474,114)	9,896,436
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	82,544,984	68,421,909
Zhvlerësimi		
Shpenzime për interesa	4,596,836	6,446,146
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	(12,841,952)	57,175,293
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(26,677,616)	(120,563,298)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	44,998,002	(17,944,263)
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	17,448,297	(5,212,638)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	85,594,437	(1,780,415)
Interesa të paguara	(4,596,836)	(6,446,146)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(3,178,581)	(2,295,154)
	(7,775,417)	(8,741,300)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(50,107,430)	(35,562,224)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(50,107,430)	(35,562,224)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	(60,687,906)	(95,922,291)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër	78,699,311	56,138,563
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	18,011,405	(39,783,728)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	45,722,995	(85,867,667)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	13 94,692,694	180,560,361
Mjetet monetare në fund të periudhës	140,415,689	94,692,694

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.




Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria FOOD TRADE është regjistruar me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë datë 03/04/2016. NIPT-i shoqërisë është K61704029H.

Shoqëria ka si objekt menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, dhënien me qira, si dhe import-eksportin e mallrave të ndryshëm që të jenë objekt i aktivitetit tregtar.

Kapitali aksioner i shoqërisë është 148,963,498 lekë i cili zotërohet nga aksionerët e shoqërisë.

Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në autostradën Tiranë-Durrës, km.6 Kashar, Tiranë. Administratori i shoqërisë është z.Pietro Tafuni.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 210 punonjës.

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen në periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2016.

Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 "Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtimit të konsolidimit" (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)

Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta" Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - (publikuar në Maj të 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). SNRF 14 "Llogaritë e shtyra për arsye rregullatore" (publikuar në janar 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më 1 janar 2016)

Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja Fillestare" (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 "Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit" (publikuar në maj 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 "Bujqësia: Bimët Bartëse"- (publikuar në qershor 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2016)

Ndryshimet në SNK 27 "Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta" (publikuar në gusht 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- Ndryshime në SNRF 9 - "Instrumentat Financiar"
- SNRF trajton klasifikimin, matjen dhe mosnjohjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, fut rregulla të reja për kontabilitetin mbrojtës dhe një model të ri zhvlerësimi për aktivet financiare. (Duhet të jetë aplikuar për vitet financiare fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).



2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara (vazhdim)

- Ndryshimet në SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët". BSNK ka nxjerrë një standard të ri për njohjen e të ardhurave. Kjo do të zëvendësojë SNK 18, i cili mbulon kontratat për mallra dhe shërbime dhe SNK 11, i cili mbulon kontratat e ndërtimit. Standardi i ri është i bazuar në parimin se të ardhurat njihen kur kontrollin e një transfereve të mira apo të shërbimit ndaj klientit. Standardi i ri është i bazuar në parimin se të ardhurat njihen kur kontrollin e një transfereve të mira apo të shërbimit ndaj klientit. Standardi lejon ose një retrospektive të plotë
- apo një qasje të modifikuar retrospektive për miratim. (I detyrueshëm për vitet financiare që fillon në ose pas datës 1 janar 2018).
- Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë". SNRF 16 është lëshuar në janar 2016. Kjo do të rezultojë në pothuajse të gjitha qiratë e njohura në bilanc, duke qënë se dallimi ndërmjet qirasë operative dhe financiare është hequr. Sipas standardit të ri, një aset (e drejta për të përdorur aset me qira) dhe një detyrim financiar për të paguar qiranë janë të njohura. Kontabilizimi i qiradhënësit nuk ka ndryshime të konsiderueshme. (I detyrueshëm për vitet financiare që fillon më ose pas datës 1 janar 2019.)
- Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat", është lëshuar në janar 2016. Kjo do të qartësojë njohjen e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara. (Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017).
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare" është lëshuar në janar 2016. Kjo qartëson se njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese që mundësojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financiare. (Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017).

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

(c) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

(d) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

(a) Të ardhurat

Të ardhurat nga kontratat përfshijnë vlerën totale të punës ndërtimore të kryer gjatë vitit. Fitimi nga kontratat afatgjata njihet me përqindjen e rregulluar mbi bazë të përfundimit. Asnjë fitim nuk merret deri kur një kontratë nuk ka avancuar deri në pikën ku fitimi përfundimtar i realizueshëm mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme. Provizionet janë krijuar për të gjitha humbjet e shkaktuara në datën e raportimit plus për cdo humbje të mëtejshme të parashikuar për sjelljen e kontratave drejt përfundimit.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Zërat jo monetare maten në bazë të kostos historike dhe nuk konvertohen në datën e raportimit.

Diferencat nga kursi i këmbimit nga zërat monetarë, njihen në fitim ose humbje të periudhës të cilës i përkasin. Fitimi dhe humbja nga monedha e huaj, raportohen në baza neto.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79




Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Instrumenta financiarë

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit. Fillimisht Shoqëria i regjistron aktivet dhe detyrimet financiare me vlerë e drejtë. Matja e mëvonshme për secilin instrument financiar, është e detajuar në shënimet e mëposhtme.

Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhën e parasë nga aktivi skadojnë ose në qoftë se transferon të drejtat për të arkëtuar flukset kontraktuale të parasë të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që është krijuar apo përfituar prej Shoqërisë njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompesuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentat financiare jo derivative të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, detyrimet tregtare dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes të koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

(d) Inventarët

Inventarët njihen me më të voglën mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot janë ato shpenzime të kryera për të sjelle çdo produkt në vendndodhjen dhe kushtet aktuale dhe përcaktohen në bazë të koston mesatare të ponderuar.

Vlera neto e realizueshme bazohet në çmimin e vlerësuar të shitjes minus çdo kosto që pritet të ndodhë në perfundim apo në nxjerrjen jashtë përdorimit.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur.

Amortizimi njihet në bazë të vlerës së mbetur, duke përdorur normat e përcaktuara nga manxhimi.

Kategoria aktiveve	Norma e amortizimit
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje kompjuterike	25%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohet për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivitetet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo date raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet financiare

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe ka patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme monetare të vlerësuar të aktivitetit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuar duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitetit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet skontimit të qendrueshëm. Kur një ngjarje e ardhshme (p.sh. shlyerja e një debitori) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(g) Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

(h) Provizionet

Një provizion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

(i) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Lehtësirat e përfituara të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

(j) Llogaritë e pagueshme dhe të shtyrat

Detyrimet njihen për shumatat të cilat duhet të paguhet në të ardhmen për të mirat dhe shërbimet e përfituara, qoftë te faturuara nga furnizuesi apo jo.



Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensione në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

(l) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare.

(m) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë.

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatuësishëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

(n) Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

(o) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një pale kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.



FOOD TRADE sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

	Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	Mjete transporti	Mobilje dhe Pajisje	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 Janar 2015	195,872,548	10,628,665	323,823,527	530,324,740
Shtesa	11,900,204	4,498,430	19,096,995	35,495,629
Transferime	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	207,772,752	15,127,095	342,920,522	565,820,369
Riklasifikime	(207,772,752)	-	70,455,579	(137,317,173)
Gjendja pas riklasifikimeve me 1 Janar 2016	-	15,127,095	413,376,101	428,503,196
Shtesa	-	1,030,782	48,558,151	49,588,933
Transferime	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	16,157,877	461,934,252	478,092,129
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 Janar 2015	52,967,012	4,997,498	69,955,138	127,919,648
Transferim	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	15,912,801	1,759,158	30,918,094	48,590,053
Kthim amortizimi	-	-	(14,082)	(14,082)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	68,879,813	6,756,656	100,859,150	176,495,619
Riklasifikime	(68,879,813)	180,768	38,397,435	(30,301,610)
Gjendja pas riklasifikimeve me 1 Janar 2016	-	6,937,424	139,256,585	146,194,009
Amortizimi i vitit	-	1,671,171	61,143,922	62,815,093
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	8,608,595	200,400,507	209,009,102
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	8,189,671	274,119,516	282,309,187
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	7,549,282	261,533,745	269,083,028

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

6. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale paraqitet si më poshte më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	AAJM	Totali
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2015	132,883,166	132,883,166
Shtesa	66,595	66,595
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	132,949,761	132,949,761
Riklasifikime	(1,475,707)	(1,475,707)
Gjendja pas riklasifikimeve me 1 Janar 2016	131,474,054	131,474,054
Shtesa	518,496	518,496
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	131,992,550	131,992,550
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2015	47,572,466	47,572,466
Transferime	-	-
Amortizimi i vitit	19,831,856	19,831,856
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	67,404,322	67,404,322
Riklasifikime	(2,135,050)	(2,135,050)
Gjendja pas riklasifikimeve me 1 Janar 2016	65,269,272	65,269,272
Transferim	-	-
Amortizimi i vitit	19,729,891	19,729,891
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	84,999,163	84,999,163
Gjendja neto më 31 dhjetor 2015	66,204,782	66,204,782
Gjendja neto më 31 dhjetor 2016	46,993,387	46,993,387

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjata

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Prapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjatë	85,164,167	106,356,219
	85,164,167	106,356,219




Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

8. Inventari

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mallra	286,257,790	274,505,782
Inventari i imët	9,426,580	8,336,636
Zhvlerësim inventari imët	(3,338,313)	(3,338,313)
	<u>292,346,057</u>	<u>279,504,105</u>

9. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë	61,654,007	43,015,794
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	-	-
	<u>61,654,007</u>	<u>43,015,794</u>

10. Llogari të arkëtueshme nga palë të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Dilo sh.p.k	-	-
EHW sh.p.k	-	-
Conad Albania sh.p.k	107,774,799	95,168,452
	<u>107,774,799</u>	<u>95,168,452</u>

11. Llogaritë të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime të arkëtueshme	10,639,037	15,205,981
Tatim mbi fitimin	2,175,196	-
	<u>12,814,233</u>	<u>15,205,981</u>




12. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime të tjera	14,861,542	10,339,211
Shpenzime të shtyra	2,803,566	3,605,838
	<u>17,665,108</u>	<u>13,945,049</u>

13. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	<u>70,595,038</u>	<u>47,642,859</u>
<i>Në lekë</i>	66,823,736	44,472,641
<i>Në valutë</i>	3,771,302	3,170,218
Likuiditete në arkë	<u>69,820,651</u>	<u>47,049,835</u>
<i>Në lekë</i>	69,820,651	47,049,835
<i>Në valutë</i>	-	-
	<u>140,415,689</u>	<u>94,692,694</u>

14. Kapitali***Kapitali***

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2016 ka qenë: 148,963,498 Lekë (2015: 148,963,498 Lekë)

Rezerva ligjore

Rezervat ligjore të kompanisë më 31 dhjetor 2016 kanë qenë në vlerën 1,101,320 Lekë (2015: 721,256 Lekë)

Fitim/(Humbje) të mbartura

Shuma prej 10,640,563 Lek përfaqëson fitimin e mbartur nga viti parardhës (2015: 3,419,345 Lekë)

Fitimi/(humbje) i/(e) ushtrimit

Shuma prej (24,474,114) Lekë përfaqëson humbjen e ushtrimit përgjatë vitit 2016.

15. Huaja afatgjatë

Huaja afatgjatë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Hua afatgjatë	36,905,149	96,669,611
	<u>36,905,149</u>	<u>96,669,611</u>

16. Hua afatgjatë nga ortakët

Huaja afatgjatë përbëhet më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Hua nga ortakët	60,915,785	61,839,229
	<u>60,915,785</u>	<u>61,839,229</u>

17. Hua afatshkurtër

Huaja afatshkurtër përbëhet më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Overdraft Societe Generale	54,179,312	56,138,563
Overdraft Intesa SanPaolo	52,577,335	-
Overdraft American Bank of Investment	1,936	-
Overdraft Veneto Bank	12,982	-
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	28,066,310	-
	<u>134,837,874</u>	<u>56,138,563</u>

18. Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Llogari të pagueshme tregtare	82,449,492	92,756,271
Furnitorë për fatura të pambërritura	8,056,721	5,563,893
	<u>90,506,213</u>	<u>98,320,164</u>

19. Llogari të pagueshme nga palët të lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
EHW sh.p.k	4,806,116	3,896,353
Conad Shqipëria sh.p.k	4,927,981	4,927,981
Conad Albania sh.p.k	530,980,990	477,703,928
	<u>540,715,087</u>	<u>486,528,262</u>




20. Parapagimet e arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime nga klientë	257,928	281,624
	<u>257,928</u>	<u>281,624</u>

21. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,126,070	1,851,758
Tatim mbi të ardhurat personale	1,130,110	1,007,339
TVSH për t'u paguar	22,062,783	24,470,542
Tatim në burim	582,515	481,115
Tatim fitimi	-	1,003,385
	<u>25,901,478</u>	<u>28,814,139</u>

22. Llogari të pagueshme të tjera

Llogarit e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paga për t'u paguar	7,552,930	7,006,001
Detyrime të tjera	86,764	99,289
	<u>7,639,694</u>	<u>7,105,290</u>

23. Të ardhura

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	2,357,043,388	2,503,516,506
	<u>2,357,043,388</u>	<u>2,503,516,506</u>




24. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten sim ë poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura të tjera	15,708,595	26,327,612
Të ardhura nga qiraja	33,349,465	18,655,999
	<u>49,058,060</u>	<u>44,983,611</u>

25. Materiale të para dhe të konsumueshme

Në këtë zë paraqitet kostoja e mallrave të shitur që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Kostoja e mallrave të shitur paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Mallra	1,879,027,963	1,979,269,281
Ndryshim gjendje inventari	(11,752,008)	50,795,565
	<u>1,867,275,955</u>	<u>2,030,064,846</u>

26. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit të shoqërisë përgjatë vitit 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:



	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për paga	99,855,748	87,529,638
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	14,689,365	13,379,913
	<u>114,545,113</u>	<u>100,909,551</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 210 punonjës.

27. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime amortizimi	82,544,987.00	68,407,827
Shpenzime zhvlerësimi për llogari të tjera të arkëtueshme	5,386,118	-
	<u>87,931,105</u>	<u>68,407,827</u>

28. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Blerje energji, avull, ujë karburant	33,981,053	35,203,249
Shpenzime transporti	18,865,508	17,972,525
Mirëmbajtje dhe riparime	16,316,532	13,714,090
Sigurime	14,165,410	13,318,819
Udhetime e dieta	35,120	193,590
Shpenzime administrative	36,250,678	34,219,970
Qira	167,431,788	159,674,608
Shpenzime ligjore dhe konsulenca	3,742,500	18,562,013
Lëndë djegëse	999,573	1,545,580
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,762,384	1,945,640
Publicitet, reklama	148,220	234,220
Komisione dhe tarifa bankare	7,762,412	8,449,112
Tatime dhe taksa të tjera	6,452,758	3,676,661
Pagesa për honorare, ndërmjetës	18,600	2,303,805
Gjoha e dëmshpërblime	414,808	2,923,333
Uniformat e punonjësve	1,529,033	1,214,633
Të tjera shpenzime	48,979,972	19,008,639
	<u>358,856,349</u>	<u>334,160,487</u>

29. Shpenzime dhe të ardhurat nga interesi dhe te ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për interesa hua	4,596,836	6,446,146
Të ardhura nga interesat	(84,227)	(190,441)
	<u>4,512,609</u>	<u>6,255,705</u>

30. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Humbjet nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzimet nga këmbimet valutore	878,593	2,714,390
Të ardhura nga këmbimet valutore	(3,424,162)	(3,909,125)
	<u>(2,545,569)</u>	<u>(1,194,735)</u>

31. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Fitimi para tatimit	(24,474,114)	9,896,436
Total shpenzime të panjohura	20,066,157	5,404,589
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	414,808	2,923,333
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	5,386,118	-
Shpenzime zhvlerësimi nga mbyllja e dyqanit	14,069,899	2,481,256
Mine Peza	195,332	-
Shpenzime të tjera të pa zbritshme	195,332	-
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(4,407,957)	15,301,025
 Humbje fiskale e mbartur		
Tatim fitimi @15%	-	2,295,154
	(24,474,114)	7,601,282

32. Palët e lidhura

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, për shembull aksionerët e Shoqërisë, dhe njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose që kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>		<u>31 dhjetor 2015</u>	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
E.H.W sh.p.k	-	4,806,116	-	3,896,353
Conad Shqipëria sh.p.k	-	4,927,981	-	4,927,981
Conad Albania sh.p.k	107,774,799	530,980,990	95,168,452	477,703,928
Dilo sh.p.k	-	-	-	-
	107,774,799	540,715,087	95,168,452	486,528,262

	<u>31 dhjetor 2016</u>		<u>31 dhjetor 2015</u>	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
E.H.W sh.p.k	604,892	22,552,585	642,538	-
Conad Shqipëria sh.p.k	-	-	-	-
Conad Albania sh.p.k	66,416,470	1,695,911,369	87,187,218	-
Dilo sh.p.k	60,753	-	-	-
	67,082,114	1,718,463,954	87,829,755	-

33. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

	31 dhjetor	
	2016	2015
Instrumenta me interes fikse		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	-
Instrumenta me interes variabël		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	36,905,149	96,669,611
	36,905,149	96,669,611

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

FOOD TRADE sh.p.k**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

33. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i Likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristikë likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	124,900,247	16,839,224	40,503,568	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	140,415,689	-	-	-
Totali	265,488,917	16,839,224	40,503,568	-
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(664,762,472)	-	-	-
Hua	-	(134,837,874)	(36,905,149)	-
Totali	(664,762,472)	(134,837,874)	(36,905,149)	-
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	(399,273,555)	(117,998,650)	3,598,419	-

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	132,796,203	18,361,327	2,232,697	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	94,692,694	-	-	-
Totali	227,488,897	18,361,327	2,232,699	-
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(134,239,593)	-	-	-
Hua	-	(56,138,563)	(96,669,611)	-
Totali	(134,239,593)	(56,138,563)	(96,669,611)	-
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2015	93,249,304	(37,777,236)	(94,436,912)	-

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

33. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			Total
	EUR	ALL	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	182,243,039	-	182,243,039
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,771,302	136,644,387	-	140,415,689
Totali	3,771,302	318,887,426	-	322,658,728
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(7,214,246)	(657,548,226)	-	(664,762,472)
Hua	(60,304,695)	(111,438,328)	-	(171,743,023)
Totali	(67,518,941)	(768,986,554)	-	(836,505,495)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2015	(63,747,639)	(450,099,128)	-	(513,846,767)

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			Total
	EUR	ALL	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	153,390,227	-	153,390,227
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,170,218	91,522,477	-	94,692,694
Totali	3,170,218	244,912,704	-	248,082,922
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(10,310,548)	(610,457,307)	-	(620,767,855)
Hua	(89,103,061)	(63,705,114)	-	(152,808,174)
Totali	(99,413,609)	(674,162,420)	-	(773,576,029)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2016	(96,243,391)	(429,249,716)	-	(525,493,108)

34. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

35. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.



Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

36. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

37. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Subjekti **FOOD TRADE SHPK**
NIPT **K61704029H**

Inventari automjeteve ne pronesi te subjektit 31.12.2016

Nr.	Lloji I automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera
1	FIAT GRANDE PUNTO	4+1	AA 342 HT	12,300 €
2	FORD FUSION	4+1	TR 8704 P	14,450 €
3	FORD TRANSIT	5+1	TR 2639 P	21,500 €
4	FORD C-MAX	4+1	TR 2060 K	6,500 €
5	FORD KUGA	4+1	AA 361 LM	27,850 €

Administratori

PIETRO PAFUNI

